




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Graçanicës (KG), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Graçanicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Llogaritë e akëtueshme të prezantuar (3,826,839€) në nenin 16 të Raportit Vjetor Financiar (RVF) ishin të nënvlerësuara për 1,190,365€;
- A2 Pasuritë Kapitale (21,530,588€) të prezantuara në nenin 19.3.1 të RVF ishin të mbivlerësuara për 200,086€;
- A3 Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 të Raportit Vjetor Financiar ishin mbivlerësuar për 58,022€;
- A4 Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 28,796€; dhe
- B1 Pasuritë jo kapitale (405,253€) të prezantuara në nenin 19.3.2 të RVF nuk ishin të plota dhe të sakta.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KG kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Graçanicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Graçanicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Graçanicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Graçanicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Graçanicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat vetjake, keqklasifikim të shpenzimeve, llogari të arkëtueshme, dobësi në regjistrimin e pasurive. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur sidomos me rastin e përgatitjes së Raportit Vjetor Financiar (RVF). RVF i Komunës i përgatitur me datë 31.01.2022 për vitin e përfunduar me 31.12.2021, nuk ishte në pajtim me Rregullën Financiare nr. 01/2017. Raporti ishte jo i saktë, prandaj ne gjatë procesit të auditimit kemi kërkuar nga menxhmenti i Komunës që RVF të korrigojohet. Pas kërkesës sonë, RVF është korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA dhe çështjet e ngritura nga ne janë korrigjuar, përveç çështjeve të raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshmeve, detyrimeve kontingjente, pasurive dhe keqklasifikimit të shpenzimeve të cilat kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit.

Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja dhe dy (2) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mos prezantim i drejtë i llogarive të arkëtueshme në RVF

Gjetja

Sipas Rregullores MF-Nr. 01/2017, për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, Neni 16 përcakton se, organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Komuna në RVF kishte prezantuar llogaritë e arkëtueshme nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë, vetëm të vitit 2021, në vlerë 228,270€, duke mos i prezantuar të përmbledhura edhe vlerat e paarkëtuara nga vitet e mëhershme, të cilat në shumë totale përfshirë edhe vitin 2021 do të duhej të raportoheshin 1,418,635€. Nga kjo rezulton se llogaritë e arkëtueshme janë të nën vlerësuar për 1,190,365€.

Dobësitë e identifikuara për llogaritë e arkëtueshme, janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin dhe harmonizimin e vlerave nga regjistrat, përkatësisht shpalosjen e tyre në RVF.

Ndikimi

Mos prezantimi i drejtë i llogarive të arkëtueshme ndikon në shpalosjen e informatave jo reale për palët e interesit përkatësisht shfrytëzuesit e pasqyrave financiare.

Rekomandimi A1

Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, në mënyrë

që të përmirësohet procesi i menaxhimit dhe prezantimit të drejtë të llogarive të arkëtueshme në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbivlerësim i pasurive kapitale

Gjetja Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1 përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël, si dhe Neni 6.3. përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Pagesat e mëposhtme ishin regjistruar si pasuri kapitale, duke mbivlerësuar regjistrin e pasurisë kapitale.

- Pagesat në vlerë 119,984€ dhe 10,000€, për furnizim me material ndërtimor është transfer kapital pasiqë përfituesit e materialit ndërtimor janë qytetarët me skema sociale.
- Pagesa në vlerë 50,000€, është transfer kapital e cila është bërë për blerjen e kamionit për bartjen e mbeturinave për Ndërmarrjen Publike Komunale.
- Pagesa në vlerë 20,102€ për furnizim me pajisje sportive i takon kategorisë mallra dhe shërbime.

Mangësitë e identifikuar lidhur me regjistrimet e pasurisë, kanë ndodhur për shkak të dobësive të zyrtarëve të pasurisë në zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me pasuritë.

Ndikimi Mos regjistrimi i drejtë i pasurisë sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, ndikon në prezentimin e informatave jo të sakta në RVF.

Rekomandimi A2 Kryetarja të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale nga zyrtarët e pasurisë në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Detyrimet kontingjente (5,313,030€), të prezantuar në nenin 18 të Raportit Vjetor Financiar (RVF) ishin të mbivlerësuar për 58,022€, sepse kjo vlerë e prezantuar ka të bëjë me padinë që ka bërë Komuna ndaj një zyrtari

komunal dhe jo me ndonjë padi që është bërë kundër Komunës.

Paraqitja e detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ka rrjedhur si rezultat i mungesës së vëmendjes të zyrtarit i cili mbanë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente si dhe nga pamjaftueshmëria e kontrollit të brendshëm nga zyrtari kryesor financiar për t'i verifikuar vlerat gjatë prezantimit të detyrimeve kontingjente në RVF.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e RVF-së të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi A3 Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së RVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Keqklasifikim i shpenzimeve

Gjetja Neni 18, paragrafi 3 i Rregulles Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “shpenzimet duhet të kenë në kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria investime kapitale kishte paguar 28,796€, për shërbimet e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të objekteve dhe hapësirave publike në Komunën e Graçanicës të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.

Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.

Rekomandimi A4 Kryetarja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurisë jo kapitale në sistemin e-pasuria

Gjetja Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.3 përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Komuna nuk kishte regjistruar pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasuria, të dhënat për pasurinë jo kapitale regjistrohen dhe evidentohen në formatin e brendshëm excel, në të cilin nuk kalkulohet amortizimi i pasurive dhe si i

tillë mbivlerëson vlerën e tyre në RVF.

Përveç kësaj kemi evidentuar gjithashtu se, 11 mostrat e testuara, në vlerë 53,327€, nuk ishin evidentuar në këtë regjistër.

Mos regjistrimi i pasurisë jo kapitale në sistemin e-pasuria, kishte ndodhur për shkak se sistemi nuk ishte funksional. Si dhe dobësive në kontrollet e brendshme nga zyrtarët e pasurisë lidhur me regjistrimin dhe prezantimin e plotë dhe të saktë të pasurive jo kapitale.

Ndikimi

Përdorimi i formateve alternative për regjistrimin e pasurisë jo kapitale, reflekton negativisht në sigurinë, saktësinë, plotësinë dhe raportimin e drejtë të pasurisë jo kapitale.

Rekomandimi B1

Kryetarja duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për aplikimin e sistemit të e-pasurisë për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2021 ishin në vlerë 1,866,079€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Çështja A5 - Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore

Gjetja Neni 21 paragrafi 3 i Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim parasheh se” Nëse kushtet e parapara me këtë ligj janë përmbushur dhe nëse aplikuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore, organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditësh për kategorinë I dhe brenda dyzet e pesë (45) ditëve për kategoritë II dhe III e lëshon lejen ndërtimore duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës. Nëse organi kompetent nuk e ka informuar aplikuesin për vendimin e tij brenda afatit të përcaktuar do të konsiderohet se leja është lëshuar. Në rastin e tillë, organi kompetent e lëshon lejen ndërtimore”.

Gjatë testimit kemi vërejtur se Komuna nuk kishte shqyrtuar lëshimin e lejeve ndërtimore brenda afatit të paraparë ligjor sepse në katër raste lëshimi i lejeve ishte bërë me vonesa nga një deri në gjashtë muaj.

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së Drejtorisë së Urbanizmit për ta lëshuar lejen ndërtimore ashtu siç është e paraparë me ligj.

Ndikimi Vonesa në dhënien e lejeve ndërtimore ndikon që aplikuesit të fillojnë ta bëjnë ndërtimin pa leje.

Rekomandimi A5 Kryetarja duhet të sigurojë se lëshimi i lejeve ndërtimore nga Drejtoria e Urbanizmit do të bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,292,012€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 2,658,655€. Ato kanë të bëjnë me shtrimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit, rregullimin e lumenjve.

Çështja A6 - Kryerja e punimeve jo në pajtim me paramasën dhe paralogarinë e kontraktuar

Gjetja Projekti “Ndërtimi i urës së armuar në Gushtericë të Poshtme “ në vlerë 23,297€, sipas paramasës dhe paralogarisë ishte paraparë të ndërtohet në gjatësi 12m. Pozicioni 5.1- Blerja, transporti dhe shtrimi me makinë finalizuese të shtresës mbajtëse nga asfalti BNS 16 të trashësisë $d = 7\text{cm}$, është në sipërfaqe 78m^2 në vlerë 624€, Pozicioni 5.2- Blerja, transporti dhe shtrimi me makinë finalizuese të shtresës grisëse nga asfalti i shkrirë AB 11 të trashësisë $d = 4\text{cm}$ në sipërfaqe 102m^2 në vlerë 612€, si dhe Pozicioni 6.2- Furnizimi me material, përgatitja dhe montimi i rrethojës prej profileve metalike me prerje tërthore $\varnothing 63\text{mm}$, sipas detalit $h=1.4\text{m}$ në gjatësi 32m në vlerë 800€.

Me datën 24.03.2022, ne së bashku me menaxherin e projektit kemi bërë një ekzaminim fizik të këtij projekti dhe kemi vërejtur se ky projekt nuk ishte përfunduar sipas paramasës dhe paralogarisë së kontraktuar sepse Pozicioni 5.1 Blerja, transporti dhe shtrimi i asfaltit $d=7\text{cm}$, ishte shtruar në sipërfaqe prej rreth 55m^2 (7.7m gjatësi + 9.3m gjatësi = $17\text{m}/2 = 8.5\text{m}$ gjatësi * 6.5m gjerësi = 55.25m^2).

Pozicioni 5.2- Shtrimi i asfaltit në trashësisë $d = 4\text{cm}$, nuk ishte realizuar fare.

Pozicioni 6.2- Montimi i rrethojës ishte bërë për 17.6m.

Vlen të theksohet se në raportin e menaxherit të projektit këto punime figurojnë si të përfunduara.

Pas pranimit të draft raportit tonë të auditimit Komuna kishte marr veprime për t'i eliminuar mangësitë e identifikuar, me ç'rast ka kërkuar nga ne të bëjmë një riekzaminim. Në riekzaminimit tonë të bërë këtij projekti me datë 05.05.2022, është vërejtur se mangësitë e identifikuar ishin eliminuar.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes joadekuate nga menaxheri i projektit.

Ndikimi Moskryerja e punimeve ashtu siç janë kontraktuar ndikon që kontrata mos të përmbushet ashtu siç është kontraktuar dhe në mosarritjen e objektivave të parapara.

Rekomandimi A6 Kryetarja duhet të shtoj kontrollet në mënyrë që menaxheri i kontratës bënë mbikëqyrjen e duhur të kontratës dhe se raportimi për realizimin e kontratës bëhet i drejtë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në RVF e pasurive kapitale është 21,530,588€, pasurive jokapitale është 405,253€, si dhe e stoqeve 6,160€.

Çështja B2 - Mos përgatitja e raportit të inventarizimit para përgatitjes të RVF-së

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Nenet 18 dhe 19 si dhe paragrafët 4.6 dhe 4.7 përcaktojnë që komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare, përgatit raportin për kryerjen e inventarizimit si dhe hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Komuna kishte formuar me vendim të kryetarit komisionin për inventarizimin e pasurisë, mirëpo komisioni kishte hartuar raportin e përgjithshëm pas përgatitjes së RVF.

Vonesat në hartimin e raportit të inventarizimit të pasurive kishin ndodhur për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme lidhur me respektimin e kriterëve për përgatitjen raportit nga komisioni i inventarizimit.

Ndikimi Mos hartimi i raportit të inventarizimit para përgatitjes së pasqyrave financiare, reflekton negativisht në saktësinë dhe plotësinë së regjistrave të pasurisë dhe në prezantimin e tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B2 Kryetarja duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme që komisioni për inventarizimin e pasurisë të hartojë raportin e inventarizimit të pasurisë para përgatitjes së pasqyrave financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në RVF e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,826,839€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 2,881,689€, të hyrat nga shpronësimi i tokës komunale 671,855€, nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë 228,270€, dënimet nga inspekcioni 26,683€ dhe nga qiraja 18,342€.

Çështja A7 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna në vitin 2021 ka shpalosur në PFV llogaritë e arkëtueshme në vlerë 3,826,839€. Pjesa më e madhe i takon tatimit në pronë në vlerë 2,881,689 apo rreth 75%, shpronësimi i tokës në vlerë 671,855€ apo rreth 18%, taksat në veprimtari në vlerë 228,270€ apo rreth 6% dhe të tjerat në vlerë 45,025€ apo rreth 1%. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte rreth 214,796€.

Dobësitë e identikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontroleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi A7 Kryetarja duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	7,839,373	8,816,914	7,978,563	11,270,839	9,065,733
Grante Qeveritare - Buxheti	5,130,120	5,167,096	5,161,256	6,355,103	5,835,035
Financimi përmes huamarrjes	0	41,897	41,897	114,030	0
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,066,287	1,066,287	812,017	2,559,741	1,488,822
Të bartura nga viti i kaluar	0	896,455	791,684	603,626	584,483
Të hyrat vetanake	1,642,966	1,642,966	1,169,815	1,580,029	1,157,393
Donacionet e jashtme	0	2,213	1,894	58,310	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 977,541€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të Ligjit të Buxhetit, Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, financimit nga huamarrja si dhe donacioneve.

Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar rreth 91% të buxhetit përfundimtar ose 7,978,563€. Kjo paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	7,839,373	8,816,914	7,978,563	11,270,839	9,065,733
Pagat dhe mëditjet	3,109,032	3,149,905	3,149,905	3,277,556	2,959,570
Mallrat dhe shërbimet	1,382,289	1,774,183	1,770,293	2,207,390	1,269,445
Komunalitë	182,000	232,000	179,976	306,358	138,143
Subvencionet dhe transferet	180,859	305,314	219,735	139,286	190,660
Investimet Kapitale	2,921,693	3,292,012	2,658,655	5,340,249	4,507,915
Rezervat	63,500	63,500	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 40,873€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga huamarrja 41,897€, mjete këto të cilat janë shpenzuar sipas vendimeve të qeverisë për shtesa gjatë pandemisë si dhe zvogëlim nga grandit i qeveris 1,024€.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 391,894€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2020, 390,000€, si dhe nga donacionet për 1,894€. Këto mjete kryesisht janë planifikuar të shpenzohen për mirëmbajtjen e rrugëve, furnizime mjekësore dhe furnizim me derivate.

Buxheti final për shpenzime komunale ishte rritur për 50,000€, nga të hyrat e pashpenzuara të vitit 2020.


Buxheti final për subvencione ishte rritur për 124,455€, nga kjo vlerë: 86,455€, rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2020, dhe 38,000€, rritje me vendim të qeverisë për vërshimet e shkaktuara në vitin 2021.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 370,319€. Kjo rritje vjen si rezultat i të hyrat vetjake të pashpenzuara nga viti 2020 në vlerë 370,000€, rritja prej 319€, ishin nga grandet e donatorëve. Këto mjete me vendim të Asamblesë Komunale ishin planifikuar të shpenzohen kryesisht për projektet: Shtrimi i rrugëve lokale, Ndërtimi, rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale, Ndërtimi i hapësirave publike, Ndërtimi i objekteve shëndetësore.

Vlen të theksohet se projekti Ndërtimi i Sistemit të Furnizimit me Ujë për Komunën e Graçanicës në vlerë 5,115,108€, financohet nga klauzola e investimeve. Për këtë projekt Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2019 kishte miratuar Ligjin Nr. 06/L-143 për ratifikimin e marrëveshjes për kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG. Nga vitin 2019 deri në 2021, ishin shpenzuar 4,860,580€, ndërsa vetëm për vitin 2021 ishin shpenzuar 812,017€.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 254,669€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2021 ishin në vlerë 1,866,079€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 158,942€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	1,642,966	1,642,966	1,866,079	2,317,164	1,624,676
Të hyrat tatimore	759,213	759,213	893,846	676,147	603,416
Të hyrat jo tatimore	883,753	883,753	972,233	1,641,017	1,021,261

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020, ka rezultuar në 9 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, shtatë (7) rekomandime ishin zbatuar dhe dy (2) tjera nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se behën korrigjimet e nevojshme mbi të dhënat e zonave të vendosura në sistemin-protax, në përputhje me Rregulloren në fuqi, në mënyrë që ngarkesa tatimore të jete e saktë dhe e drejt për të gjithë obliguesit e tatimit në pronë.	Nga mostrat tona të testuara nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet regjistrohen në kategoritë dhe kodet përkatëse ekonomike.	Komuna kishte ndërmarr veprime konkrete duke adresuar rekomandimin e dhënë. Nuk kemi vërejtur ndonjë rast në kuadër të mallrave ku kishte regjistrime në kode ekonomike jo adekuate.	I zbatuar

3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin dhe evidentojnë në raportet e pranimit dhe ditarët e punës sasinë e furnizimeve dhe shërbimeve të kryera. Kryetari në bashkëpunimin me kompaninë kontraktuese duhet të qartësojë aspektin e çmimit të kontraktuar dhe ti përmbahet çmimeve të kontraktuara të dhëna në shtojcën D të Marrëveshjes.	Nga mostrat tona të testuara nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i përzgjedhjes së projekteve për financim të zhvillohet duke aplikuar të gjitha kërkesat dhe formatet/formularët standard të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04 2017 për subvencionim të OJQ-ve, si dhe duhet të shtojë masat e kontrollit në monitorimin e projekteve të financuara. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë të bëhet në pajtim me rregullat e MFK-së ashtu që zyrtarët të mos përfshihen në më shumë se në një fazë të procesit.	Nuk kemi vërejtur ndonjë çështje në vitin 2021.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që nënshkrimi i kontratave bëhet në përputhje me fondet e buxhetuara dhe aprovuar, në mënyrë realizimi i projekteve të jetë sipas planit për të parandaluar shpenzime tjera shtesë.	Nga pesë mostrat e testuar për procedurat e prokurimit kemi vërejtur se për të gjitha mostrat (pesë) mjetet ishin të buxhetuara me ligj a po zotimi ishte bërë në përputhje me vlerën e kontratës.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të marrë veprime të nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhim dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga MAP, në mënyrë që ti mundësohet komunës që të funksionalizoj sistemin e-pasuria.	Edhe në vitin 2021 kishte problem me funksionimin e sistemit të e-pasurisë si dhe regjistrimi i pasurive nën 1,000 euro nuk ishte bërë në pajtim me rregulloren.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni për inventarizim të pasurisë të hartojë raportin për inventarizimin e pasurive para datës së përgatitjes së PFV-ve.	Edhe për vitin 2021 inventarizimi i pasurive ishte bërë pas datës së përgatitjes së RVF-së.	Nuk ka filluar zbatimin

8.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i automjeteve kontrollohet nga personat përgjegjës të emëruar paraprakisht të cilët aplikojnë dokumente dhe aprovojnë kërkesat sipas rregullave duke ofruar dëshmi përkatëse se veturat përdoren për nevoja të komunës. Furnizimi me derivate të bëhet në mënyrë të kontrolluar apo nga personat e paracaktuar dhe nevojës për riparimi të automjeteve duhet ti paraprijë kërkesa dhe bashkëngjitet aprovimi nga niveli përgjegjës.	Komuna kishte ndërmarr veprimet e nevojshme dhe kishte zbatuar rekomandimin e dhënë. Nga mostrat e testuar ne kemi vërejtur se në të gjitha rastet aprovimet e kërkesave ishin bërë nga personat përgjegjës.	I zbatuar
9.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se çertifikimi i pagesave bëhet vetëm pasi lëndët të jenë kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm. Obligimet financiare të paguhen brenda afatit ligjor, dhe se zotimi i mjeteve financiare në SIMFK ti paraprijë kërkesave për furnizim të mallrave dhe shërbimeve.	Nga mostrat tona të testuara nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Faik Thaqi, Anëtar i ekipit



Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

	ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА KOMUNA E GRAÇANICËS MUNICIPALITY OF GRAÇANICA	
---	--	--

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Graçanicës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Prof. dr Ljljana Šubarić
Kryetarja e Komunes se Graçanicës

Data: 05.05.2022, Graçanicë,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.